29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose

- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshhtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëshmipërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Neni. Nr.	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 60 ditë.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës..

	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të përcaktohet nga menaxheri i kontratës.
	17.2	Data e përfundimit të gjitha Punëve do të jetë 30 ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit përcaktohet nga ZKA.
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në vlerë 50.000,00 € e më shumë në bazë të raportit të ekipit menaxhues.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% e vlerës së kontratës.
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të përcaktohet nga menxheri i kontratës pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 2 vite për punime tjera ndërsa 3 vite për punët e zdrukthëtarisë .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar e punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndermjetesim pranë Ministrisë së Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike

		<p>të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p>
--	--	--

		<p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	--	---

RENOVIMI I OBJEKTIT TË TRAFIKUT URBAN					
Paramasa dhe parallogaria					
PUNËT NDËRTIMORE DHE ZEJTARE					
Kushte të përgjithshme					
Përshkrimi i punëve. Në përputhshmeri të plote me standardet EC dhe ISO.					
Paramasat dhe parallogaria është e dhënë detalisht në përshkrimin teknik, dhe i nënshtrohet përshkrimit teknik.					
Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtës. Pra në këto mënyra duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtës dhe vendosjes e materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preveniva) hapësirë në mes të zonës nën ndërtim (RENOVIM) dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtës.					
Punishtëja të rrethohet me tabela prej llamarine dhe me konstrukcion të përfortuar mirë në toke. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikujqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve egzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.					
Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristikat të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO.					
Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vurjen në vepër të materialeve për secilin pozicion si dhe të gjitha punët dhe materialet e nevojshme përcjellëse që aktivitetet të jenë funksionale (skelet, masat mbrojtëse për siguri në punë etj.)					
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
1	PUNIMET PËRGADITORE				
1.1	Inqizimi gjeodezik i lokacionit. Sip. Sp. teknik,	m ²	39,388.30	0.03 €	1,161.65 €
1.2	Preventiva hapësirë në mes të zonës nën NDËRTIM (renovim) dhe zonave tjera në afërsi. Sip. Sp. Teknik.	komplet	1.00	380.00 €	380.00 €
1.3	Shkyqja e përkohëshme e instalimeve eksistuese si dhe rikujqja e tyre pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe preventivi i konservimit të instalimeve egzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas ndërtimit të objektit	komplet	1.00	750.00 €	750.00 €
				Shuma 1:	2,311.65 €
2	PUNËT E DEMOLIMIT DHE PASTRIMIT				
2.1	Pastrimi i dyshemesë së objektit, pozicioni përfshinë dyshemet pllaka keramike pastrim i dyshemesë me ujë me shlypje (pjesa ku dyshemeja i është ekspozuar vajrave), etj. dhe largimi i mbeturinave në deponi të caktuar nga organi mbikëqyrës, jo më pak se 5 km	m ²	1,831.02	0.30 €	549.31 €
2.2	Gryerja e sipërfaqes së ngjyrës, gletit, pllakave të qeramikes si dhe shtatimit në mure, pozicioni përfshinë edhe pastrimin e punishtës gjatë gjithë kohës së realizimit të këtijë aktiviteti si dhe largimi i mbeturinave në deponi të caktuar nga organi mbikëqyrës, jo më pak se 5 km	m ²	105.00	2.00 €	210.00 €
2.30	Çmontimi dhe dërgimi në deponi i dyerve dhe dritareve në objekt. Të gjitha materialet të largohen në deponi të caktuar nga organi mbikëqyrës, jo më pak se 5 km. Pajisjet e vendosura në dritare të çmontohen me kujdes pa u demtuar dhe vendosja e tyre përcaktohet nga organi mbikëqyrës				
	Dimensionet				
	Dritaret				
	180/120	copë	2.00	15.00 €	30.00 €
	200/155	copë	2.00	15.00 €	30.00 €
	390/120	copë	1.00	15.00 €	15.00 €
	390/80	copë	4.00	15.00 €	60.00 €
	425/100	copë	24.00	15.00 €	360.00 €
	425/190	copë	27.00	18.00 €	486.00 €
	470/120	copë	1.00	15.00 €	15.00 €
	570/120	copë	2.00	20.00 €	40.00 €
	150/370	copë	1.00	15.00 €	15.00 €
	220/170	copë	1.00	15.00 €	15.00 €
	260/160	copë	1.00	15.00 €	15.00 €
	255/110	copë	1.00	10.00 €	10.00 €
	235/190	copë	1.00	10.00 €	10.00 €
280/190	copë	4.00	10.00 €	40.00 €	
425/155	copë	44.00	30.00 €	1,320.00 €	
425/220	copë	62.00	30.00 €	1,860.00 €	
570/190	copë	2.00	50.00 €	100.00 €	
				Shuma 2:	5,180.31 €

3	PUNET E MURATIMIT DHE SUVATIMIT				
	Siperfaqja është e kalkuluar bruto përfshirë shpaletat, këndoret e nevojshme nga prodhuesi, fugat e dilatimit për fasadë, këndoret me ngjites nga PVC rreth dritareve - hapjeve. Hapjet zbriten nëse janë me të mëdha se 3m ² (vetëm hapjet deri në 3m ² llogariten në sipërfaqe bruto). Në këtë pozicion përfshihen edhe të gjitha materialet përcjellëse të nevojshme për realizimin e aktivitetëve.				
3.1	Furnizimi dhe montimi i mureve ndarese nga gips pllakat me trashësi 12.5cm. Nga të dy anet e jashtme duhet të vendosen 2x2 pllaka nga 12.5mm ndërsa në mes duhet vendosur konstruksioni metalik si dhe shtresa nga leshi mineral për izolim termik dhe akustik. Klasa e qëndrueshmërisë nga zjarri F90, mbrojtja nga zhurma 54dB.	m ²	131.54	22.00 €	2,893.88 €
Shuma 3:					2,893.88 €
4	PUNET E LYERJES DHE FASADES				
	Siperfaqja është e kalkuluar bruto përfshirë shpaletat, këndoret e nevojshme nga prodhuesi, fugat e dilatimit për fasadë, këndoret me ngjites nga PVC rreth dritareve - hapjeve. Hapjet zbriten nëse janë me të mëdha se 3m ² (vetëm hapjet deri në 3m ² llogariten në sipërfaqe bruto). Në këtë pozicion përfshihen edhe të gjitha materialet përcjellëse të nevojshme për realizimin e aktivitetëve. Sipërfaqet e fasadës duhet të jenë të thata para se të ngjyrosen. Sipërfaqet të lyhen në se paku dy shtresa, përkatesisht atë herë sa mjafton që ngjyra në fasadë tërësisht të njëjtësohet. Kalkulimi për m ² .				
4.1	Gletimi i mureve me glet masë në min dy shtresa.	m ²	145.00	3.80 €	551.00 €
4.2	Ngjyrosja me baze në dy shtresa.	m ²	145.00	0.50 €	72.50 €
4.3	Ngjyrosja e mureve dhe tavanit në tri shtresa. Ngjyrë disperzive e kualitetit të lartë me bazë akrilike, ekologjike. - Dedicuar për dekorimin e mureve të brendshme dhe të jashtme. - Lehtë të aplikueshëm, difuz në ujë dhe ajër. - I qëndrueshëm në fërkim dhe pastrim me leckë. - I përshatshëm për nuancim. - Pa materie që avullohen.	m ²	88.38	3.60 €	318.17 €
4.4	Ngjyrosja e llamarinës së tavanit në tri shtresa në sallën e mesit. Ngjyrë e kualitetit të lartë. Siperfaqja duhet me pare të pastrohet me kujdes që mos të demtohen punët parapara.	m ²	1,070.00	2.20 €	2,354.00 €
4.5	Pastrimi i fasadës, grryerja e shtresave të papastërta në fasadën prej tullave, lyerja me ngjyrë të ngjajshme atë ekzistuese si dhe lyerja me shtresë mbrojtëse në përputhje me normat teknike të parapara për konservimin e tullave në fasadë.	m ²	35.32	1.50 €	52.98 €
4.6	Lyerja e fasadës me ngjyrë në tri shtresa. Ngjyrë disperzive e kualitetit të lartë me bazë akrilike, ekologjike. - Dedicuar për dekorimin e mureve të brendshme dhe të jashtme. - Lehtë të aplikueshëm, difuz në ujë dhe ajër. - I qëndrueshëm në fërkim dhe pastrim me leckë. - I përshatshëm për nuancim. - Pa materie që avullohen.	m ²	35.32	3.00 €	105.96 €
4.7	Pastrimi i fasadës si dhe inpregnimi i elementeve prej betoni (serklazhili, shtyllave dhe trajeve) ky pozicion realizohet në përputhje me normat teknike të parapara për konservimin e elementeve të betonit në fasadë.	m ²	1,187.96	2.20 €	2,613.51 €
Shuma 4:					6,068.12 €
5	PUNET E HIDROIZOLIMIT				
5.1	Furnizimi me material dhe montimi i hidroizolimit të flohtë dykomponentësh në dysheme të objektit, në njërin sanitarë me ngritje në mure në lartësi minimale 60 cm dhe në dushë deri 280 cm, kjo përfshinë tharjen e dyshemesë, llogaritja më m ² të sipërfaqes së punuar.	m ²	22.50	9.00 €	202.50 €
Shuma 5:					202.50 €
6	PUNET E DYSHEMESË				
6.1	Furnizimi me material dhe shtruarja e estrih betonit me trashësi 5 cm, me armature rrethë Ø4/15 cm dhe PV Folie (Verejtje: estrih betoni duhet ta mbrijë fortësinë e nevojshme). Lageshtia e estrihut para shtrirjes së dyshemesë duhet të jetë < 4%.	m ²	8.50	9.20 €	78.20 €
6.2	Furnizimi me material si dhe punimi i dyshemesë me epoksit, i cili realizohet me rreshtim epoksite vetënivelizuese, e pigmentuar, 2 komponente me forcues aminik i modifikuar e paracaktuar kryesisht për subtrakte prej çimento që janë shumë të ngarkuara kimikisht dhe mekanikisht, psh. Depo, laboratore, spitale, industri ushqimore, salla për prodhim, garazha etj. Në gjendje të ngurtë duhet të jetë shumë e fortë elastike rezistente në haxhim në acide, vajra minerale. Lloji i rreshtës epoksite vetënivelizuese përfundimtare duhet të jetë rezistente në acide, pozicioni i përshinë këto aktivite: - Pastrimi i dyshemesë nga pluhuri Sistemi i dyshemesë epoksite (trashësia 1.5mm) realizohet me shtresat si vijon: Së pari lyhet dyshemeja me lyerje epoksite bazë, dy shtresa lyerje me material epoksit përfundimtar i përzier me rërë kuarci (ES-epoxy sand) si dhe një shtresë përfundimtare epoksite. Vendorsja e epoksitit duhet të behet konform Standardit EN 13813. Në çmim duhet të përfshihen edhe llajset këndoret si dhe të gjitha materialet dhe punët tjera të nevojshme për të arritur produktin final.	m ²	165.00	23.00 €	3,795.00 €
6.3	Furnizimi me material si dhe montimi i laminatit t=10mm në dyshemenë e pllakës së meskatit. Në çmim të parashihet edhe montimi i llajseve këndore.	m ²	162.30	12.00 €	1,947.60 €
Shuma 6:					5,820.80 €

7	PUNËT E PLLAKAVE				
7.1	Furnizimi dhe instalimi i pllakave te dyshemese nga porcelani Klasi i pare, dy her te pjekura, sipas EN 14411:2004(ISO 13006). Fortesija min. 50N/mm2 sipas UNI EN ISO 10545-4.Rezistenca ndaj abrazionit te permbush kushstet sipas UNI EN ISO 10545-6 Rezistenca ndaj Ngricave duhet te ketaj grupit Bla Klasa(UGL) sipas UNI EN 14411, Apsorbimi i ujit duhet te jete me e ulet se 0.5%, Rezistenca ndaj acideve dhe bazave sipas NI EN ISO 10545-13. Vendosja e pllakave duhet te behet konform Standardit EN 13888. Ne cnim duhet te perfshihen edhe kendoret e Aluminit, ngjitsi, dhe te gjitha punet tjeta te nevojshme per te arritur produkljn final.	m ²	15,50	18 00 €	279 00 €
7.2	Furnizimi dhe instalimi i pllakave te murit nga porcelani Klasi i pare, dy her te pjekura, sipas EN 14411:2004(ISO 13006). Fortesija min. 50N/mm2 sipas UNI EN ISO 10545-4.Rezistenca ndaj abrazionit te permbush kushstet sipas UNI EN ISO 10545-6.Rezistenca ndaj Ngricave duhet te ketaj grupit Bla Klasa(UGL) sipas UNI EN 14411, Apsorbimi i ujit duhet te jete me e ulet se 0.5%, Rezistenca ndaj acideve dhe bazave sipas NI EN ISO 10545-13. Vendosja e pllakave duhet te behet konform Standardit EN 13888. Ne cnim duhet te perfshihen edhe kendoret e Aluminit, ngjitsi, dhe te gjitha punet tjeta te nevojshme per te arritur produkljn final. H=220cm	m ²	66 00	16 00 €	1 056 00 €
Shuma 7:					1 335 00 €
8	PUNËT E ZDRUKHTARISË				
	Vërejtje: Te punët e zdrukhtarisë para fillimit të punimeve për përgaditjen, transportin si dhe montimin e dyerve dhe dritareve të reja, të gjitha dimensionet të maten në vend. Ne çnim te flogaritet edhe ljerja me llaç, gjetimi, si dhe ngjyrosja me ngjyre minimum tri shtresa rreth dritares.				
8.1	Furnizimi dhe montimi i dritareve nga <u>profilet e aluminit me urë termike të prodhuesit ALUMIL ose ekuivalent</u> , xham termopan me mbushje Argoni (4+16+4). Dritaret duhet te ankorohen me bulona te galvanizuar, dhe duhet te kenë mekanizma për hapje mbyllje, sipas skemës së dritareve në projekt.				
	180/120	copë	2 00	240 00 €	480 00 €
	200/155	copë	2 00	340 00 €	680 00 €
	390/120	copë	1 00	550 00 €	550 00 €
	390/80	copë	4 00	355 00 €	1 420 00 €
	425/100	copë	24 00	485 00 €	11 640 00 €
	425/190	copë	27 00	962 00 €	25 974 00 €
	470/120	copë	1 00	620 00 €	620 00 €
	570/120	copë	2 00	750 00 €	1 500 00 €
8.2	Furnizimi dhe montimi i dritareve nga <u>profilet e aluminit me urë termike të prodhuesit ALUMIL ose ekuivalent</u> , xham termopan me mbushje Argoni (4+16+4). Dritaret duhet te ankorohen me bulona te galvanizuar, dhe duhet te kenë mekanizma për hapje mbyllje, kiper sipas skemës së dritareve në projekt. Hapjet e dritareve për ventilim të cilat e kalojnë lartësinë mbi 4m duhet te kenë mekanizma për hapje te vendosura ne atë mënyre qe te hapin edhe dritaren e epërme edhe atë te poshtme pernjehere, si dhe te mund te përdoret nga personi ne pozite te ngritur.				
	150/370	copë	1 00	610 00 €	610 00 €
	220/170	copë	1 00	410 00 €	410 00 €
	260/160	copë	1 00	455 00 €	455 00 €
	255/110	copë	1 00	310 00 €	310 00 €
	235/190	copë	1 00	490 00 €	490 00 €
	280/190	copë	4 00	650 00 €	2 600 00 €
	425/155	copë	44 00	860 00 €	37 840 00 €
	425/220	copë	62 00	1 163 00 €	72 106 00 €
	570/190	copë	2 00	1 290 00 €	2 580 00 €
8.3	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i mureve ndarëse prej ramil me <u>profilet e aluminit me urë termike të prodhuesit ALUMIL ose ekuivalent</u> , xhami termopan me mbushje Argoni (4+16+4). Rami duhet te ankorohet me bulona te galvanizuar dhe mekanizma për hapje mbyllje, sipas skemës së ramit në projekt., duhet te parashihet edhe nje hapje-dere xhami per hyrje.				
	405/270	copë	1 00	1 200 00 €	1 200 00 €
	520/270	copë	1 00	1 496 50 €	1 496 50 €

8.4	Furnizimi dhe instalimi i dyerve te kualiteti te larte per penderim te shpeshte nga prodhuesi NOVOFERM, HORMAN ose ekuivalent. Krahu i deres: Izolimi i var mbushje me perform tubular, mbeshhtjellës metalic te galvanizuar me trashësi min 0.9mm dhe me ngjyrosje pluhur termike, 40mm të trasha. Dy bagllame tre-pjeseshe dhe dorezën e lakuar ne skaje. Korniza llamarine 2mm te galvanizuar dhe me ngjyrosje pluhur termike, me ankerë për mure, min. 22cm te thellë. Gome mbijllaje ne tri ana. Koeficienti i rezistencës ndaj zjarrit T30 min. Izolimi i nxehtësisë ud = 1.9W/(m².K). Izolimi akustik në përputhje me EN 20140/717-1 deri në RW 46dB. Dera duhet të jetë me ngjyre të bardhë RAL 9016. Dyert duhet të kene cilindrin dhe celesat për mbyllje dhe hapje te tyre				
	70/210	copë	2.00	220.00 €	440.00 €
	90/210	copë	2.00	240.00 €	480.00 €
				Shuma 8:	163,881.50 €
9	RREGULLIMI JASHTEM				
9.1	Grryerja e një shtrese asfalti, thellësia e grryerjes min 40mm, pozicioni të realizohet me mjete adekuate për këtë aktivitet. Pozicioni përfshinë edhe ngarkimin, transportin si dhe shkarkimin e materialit deri në deponinë të caktuar nga ana e organit mbikëqyrës.	m²	5,933.16	0.60 €	5,339.84 €
